



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI EKONOMIK
DEKANATI

Nr. 231/1 prot.

Elbasan, me 26.10.2020

VENDIM

Nr. 12 datë 26.10.2020

"PËR
MËNYRËN ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR
NË FAKULTETIN EKONOMIK TË UE"

Në mbështetje të nenit 43 të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statutit të UE, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.5, datë 30.01.2018, neni 19; "Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Universitetit të Elbasanit", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.22, datë 12.04.2020, neni 27; si dhe në zbatim të Vendimit të Rektoratit të UE nr.1, date 26.10.2020 "Për mënyrën zhvillimit të procesit mësimor në Universitetin e Elbasanit "A.Xhuvani", për vitin akademik 2020-2021", Dekanati i Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2020,

VENDOSI:

1. Procesi mësimor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për të gjitha programet e studimit, në të gjitha vitet, do të fillojë të zhvillohet në auditor, sipas planeve mësimore, duke respektuar orarin e miratuar.
2. Nëse gjatë zhvillimit të mësimin në auditor, do të konstatohet se numri i madh i studentëve e bën të pamundur respektimin e masave të distancimit, për ruajtjen nga rreziku i COVID-19, Dekanati do të miratojë ndryshimin e metodologjisë së zhvillimit të mësimin duke kaluar në mësimdhënien e kombinuar në auditor dhe on line.
3. Ky vendim i përcillet Rektoratit për procedura të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI
Prof. as. Dr. Imelda SEJDIRI

